

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Përcaktimi i pagës minimale në shkallë vendi

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 1025 date 16.12.2020
Vendosi që:

- Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 30 000 lekë.
- Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj të kryera gjatë kohës normale të punës.
- Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 lekë.
- Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

Lista e subjekteve sipas formës ligjore "Ent Publik" për tatimpaguesit që do të kryejnë procesin e Fiskalizimit

Administrata Tatimore ka njoftuar se prej datës 1 Janar 2021 tatimpaguesve të cilët kryejnë transaksione shitje me entet publike kanë detyrimin që të lëshojnë vetëm fatura elektronike për mallrat apo shërbimet e shitura.

Po kështu, dhe entet publike, pas kësaj date, për mallrat apo shërbimet e blera nga tatimpaguesit do të pranojnë vetëm Faturën elektronike, e cila do të jetë dokumentacion i vetëm i vlefshëm tatimor për furnizimet e marra.

Për të lexuar listën e subjekteve sipas formës ligjore "Ent Publik" (me status AKTIV gjithsej 1538 ente), kundrejt të cilave çdo tatimpagues në bazë të Ligjit Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", mban detyrimin të lëshojë faturë elektronike të fiskalizuar, klikoni në linkun më poshtë:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1476/lista-e-subjekteve-sipas-formes-ligjore-ent-publik-per-tatimpaguesit-qe-do-te-kryejne-procesin-e-fiskalizimit>

Procedura e lëshimit të faturave elektronike

Që nga data 1 Janar 2021, faturat që do të lëshohen për Organet Publike Shtetërore duhet të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave.

Ndërsa për faturat që do të lëshohen ndërmjet tatimpaguesve, duhet të jenë Fatura Elektronike dhe shkëmbehen nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave duke filluar nga data 1 Korrik 2021.

Për të lëshuar Faturë Elektronike kërkohet që tatimpaguesit të përmbushin kërkesat si më poshtë:

1. Akses në Internet në vendin e lëshimit të faturave elektronike
2. Pajisja me Certifikatë Elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
Shërbimi: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13691
3. Aksesimi i Platformës Qendrore të Faturave duke përdorur kredencialet tuaja të aksesit nëpërmjet E-Albania, në adresën: <https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care>
4. Plotësimi i të dhënave për procesin e fiskalizimit sipas nënpikave:

- Përcaktimin e ofruesit të internetit për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e pronësisë së ambientit dhe sipërfaqes për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e rregullit të numrit rendor të faturave
- Përcaktimin e aktiviteteve të biznesit referuar kodeve
- Përcaktimin e orëve të punës për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Përcaktimin e koordinatave në hartë për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Shtimin e kontakteve për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit
- Shtimin e operatorit/ëve që do të lëshojë faturë elektronike
- Ngarkimin e Certifikatës Elektronike me qëllim fillimin e procesit të lëshimit të faturave elektronike

Për më shumë, mund t'i referoni faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në adresën: <https://www.tatime.gov.al/c/424/fiskalizimi>